Korpusi i Paqes Shqipëri

RAPORTI VJETOR 2017

FESTOJMË
20 VJET NDIKIM

Mesazh nga Ambasadori Amerikan në Shqipëri, Z. Donald Lu

Të dashur vullnetarë, qytetarë shqiptarë dhe personel i Korpusit të Paqes:

Më lejoni të përgëzoj programin e Korpusit të Paqes në Shqipëri për punën e mrekullueshme që ka bërë vitin e kaluar. Kam pasur kënaqësinë të vizitoj vullnetarë në Pukë, Përmet, Shkodër dhe Vlorë. Më pëlqen që vullnetarët jo vetëm flasin bukur shqip, por madje kanë mësuar edhe theksin dhe dialektin e zonës ku janë vullnetarë. Ka qenë tepër mbresëlënëse të shihja marrëdhënien e ngrohtë ndërmjet vullnetarëve dhe kolegëve të tyre shqiptarë.

Të jesh vullnetar i Korpusit të Paqes do të thotë të kesh kurajë dhe shpirtin e sakrificës. Ata qëndrojnë larg familjes dhe miqve për dy vjet. Ata duhet të përballen me sfida, të mësojnë nga dështimet dhe të frymëzojnë të tjerët për t'i bërë ballë vështirësive. Ata duhet t'i mirëpresin përvojat e reja krahëhapur dhe të shfrytëzojnë çdo mundësi.

Shumë nga vullnetarët tanë e shpenzojnë shumicën e kohës së tyre me të rinjtë shqiptarë. Ajo që mund të them është thjesht*, Ju lumtë!*

Ky është brezi që e meriton kohën dhe vëmendjen tonë. Këta të rinj janë e ardhmja e këtij vendi të bukur.

Sincerely,

Donald Lu

Mesazh nga Drejtoresha për Shqipërinë, Kate Becker

Të dashur miq, partnerë, kolegë dhe vullnetarë të Korpusit të Paqes:

Viti 2017 ishte një tjetër vit i mrekullueshëm për Korpusin e Paqes Shqipëri. Historia jonë 20-vjeçare po pasurohet gjithnjë e më tepër dhe kemi dhënë kontribute domethënëse në të gjithë vendin. Puna jonë vjen si rezultat i pesë kontributeve të rëndësishme:

1. Stafi i talentuar dhe i apasionuar i Korpusit të Paqes, që shërben në misionet e Korpusit të Paqes, vit pas viti;
2. Agjencitë e punës që kanë shënuar ecuri dhe e shtyjnë veten në depërtimin dhe ndikimin që kanë;
3. Kolegët e dashur dhe të përkushtuar në komunitetet e tjera të vendit, që punojnë krah për krah me vullnetarët tanë, duke dhënë nga koha dhe aftësia e tyre për t'i bërë komunitetet të ecin përpara;
4. Ngrohtësia dhe mikpritja e familjeve pritëse, që ofrojnë strehimin dhe ndjesinë e përkatësisë për vullnetarët tanë, ndërkohë që ndajnë vaktet, kulturën dhe gjuhën shqiptare; dhe
5. Amerikanët, që lanë karrierat e tyre pezull, familjen, miqtë dhe rehatinë e tyre, për të udhëtuar me mijëra kilometra për të jetuar, punuar, shërbyer dhe mësuar në komunitete të ndryshme në të gjithë Shqipërinë. Këta amerikanë dhe vullnetarët e Korpusit të Paqes janë të përkushtuar për ta bërë botën një vend më të mirë.

Vullnetarët do t'ju tregojnë se aspekti më i rëndësishëm i punës së tyre është populli shqiptar, duke përfshirë mësuesit, nëpunësit, dhe punonjësit e përkushtuar të OJF-ve, kampionët e komunitetit, po ashtu të rinjtë mendjendritur, me ide të reja dhe sipërmarrës, në të gjithë vendin. Nuk ka ndikim më të madh sesa marrëdhëniet personale dhe lidhjet e vërteta, që formohen gjatë shërbimit dy-vjeçar të një vullnetari. Kjo gjë e thekson horizontin e ndritur të Shqipërisë.

Jemi krenarë që jemi Korpusi i Paqes Shqipëri,

Kate M Becker

Kate M Becker

Misioni dhe qëllimet e Korpusit të Paqes

Në vitin 1961, Presidenti i Shteteve të Bashkuara, John F. Kennedy, themeloi Korpusin e Paqes për të ushqyer të kuptuarit dhe për të nxitur miqësinë ndërmjet amerikanëve dhe popujve të shteteve të tjera.

Misioni i Korpusit të Paqes është të nxisë paqen në botë dhe miqësinë, duke përmbushur tre qëllime:

1. Të ndihmojë popujt e vendeve të interesuara, që të përmbushin nevojat e tyre për burra dhe gra të trajnuar.
2. Të ndihmojë në nxitjen e mirëkuptimit të amerikanëve për popujt që përfitojnë shërbimet.
3. Të ndihmojë në nxitjen e mirëkuptimit të popujve të tjerë për amerikanët.

Korpusi i Paqes ndryshon jetë, jetët e njerëzve në komunitetet rreth botës dhe jetët e vullnetarëve.

- Në Korpusin e Paqes kanë shërbyer më shumë se 230,000 amerikanë në 141 vende të botës.
- Në Shqipëri kanë shërbyer më shumë se 790 vullnetarë të Korpusit të Paqes, që prej vitit 1992.

Korpusi i Paqes Shqipëri

Në vitin 1991, Qeveria Shqiptare ftoi Korpusin e Paqes për të themeluar një program brenda vendit. Grupi i parë i vullnetarëve mbërriti në vitin 1992, duke u marrë dy vjet me mësimdhënien e gjuhës angleze në shkollat e mesme dhe në universitete. Nga viti 1993 deri në vitin 1996 mbërritën katër grupe vullnetarësh shtesë, për mësimdhënien e gjuhës angleze, mbështetjen e zhvillimit të bizneseve të vogla, ose mbështetjen e menaxhimit të agrikulturës dhe pyjeve. Korpusi i Paqes e mbylli programin e tij në Shqipëri në vitin 1997 për shkak të trazirave politike dhe shqetësimeve për sigurinë e vullnetarëve.

Në vitin 2002, Qeveria Shqiptare e ftoi Korpusin e Paqes për të rihapur një program dhe mori pjesë në një vlerësim të kryer nga Korpusi i Paqes. Sipas këtij vlerësimi, pjesëtarët e parë të stafit të Korpusit të Paqes mbërritën në mars të vitit 2003, për të ngritur një zyrë dhe për të rihapur programet.

Që prej vitit 2003, 623 vullnetarë kanë punuar me qeveritë vendore, OJF-të, shkollat dhe institucionet shëndetësore, në tre fusha të projektit:

- Mësimdhënie e gjuhës angleze
- Edukimi shëndetësor
- Zhvillimi i komunitetit dhe organizimit

Programi i Korpusit të Paqes është rihapur me ftesë të Qeverisë Shqiptare dhe operon sipas marrëveshjes ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, që njeh rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve të përfitimit reciprok dhe bashkëpunimit.

Festojmë 20 vjet në Shqipëri 1991-1999

Kevin McLaughlin (majtas) dhe Altin Veshti (djathtas) në vitin 2014, 20 vjet pas takimit të parë si vullnetar i Korpusit të Paqes Shqipëri dhe si student.

Mbështetja e të rinjve - Kevin McLaughlin shërbeu si vullnetar i Korpusit të Paqes (VKP), nga viti 1994 deri në vitin 1996. Ai ishte nga shteti i Vermont dhe shërbeu në qytetin e Lezhës. Kevini përjetoi shumë sfida si mësues i gjuhës angleze, në Shqipërinë që po zhvillohej.

Veprimtaria - Kevini formoi një grup debati, ku mësonte aftësitë e mendimit kritik. Pjesëtarët e grupit, duke përfshirë Altin Veshtin, morën pjesë në konkurset rajonale. Kevini e nxiti Altinin që "të ishte guximtar dhe i patrembur" dhe të ndiqte ëndrrat e tij.

Ndikimi - Altini dhe familja e tij u shpërngulën në Itali. Altini fitoi të drejtën për të studiuar për mjekësi, u kthye në Shqipëri dhe u shndërrua në një nga kirurgët më të mirë të zemrës për fëmijë. Sot, Altini punon si vullnetar me *Mjekët pa Kufij* në Afrikë, duke e kujtuar Kevinin si shembullin e tij të parë të ndikimit që një vullnetar pati në jetën e tij dhe duke ua shpërblyer ndikimin e tij personave të tjerë.

1991 — Qeveria Shqiptare ftoi Korpusin e Paqes për të themeluar një program brenda vendit

QERSHOR 1992 — Mbërriti në Shqipëri grupi i parë me 21 vullnetarë të Korpusit të Paqes

1994-1996

1997 — Korpusi i Paqes e mbylli zyrën e tij në Shqipëri për shkak të trazirave politike dhe shqetësimeve për sigurinë e vullnetarëve

Festojmë 20 vjet në Shqipëri 2003-2009

Eliminimi i dhunës në familje dhe fuqizimi i grave - Vullnetarja Juliet Kosarzycki, nga Uiskonsin, shërbeu në Shqipëri nga viti 2006 në vitin 2008. Ajo donte të trajtonte çështjet e fuqizimit të grave dhe dhunës në familje, në komunitetin e saj në Kuçovë. Ndërsa Dita Ndërkombëtare për Eleminimin e Dhunës Kundër Grave po afrohej, ajo mori në konsideratë se si ta përqendronte vëmendjen te ky problem.

Veprimtaria - Juliet punoi me pjesëtarët e Qendrës Rinore Kuçovë për organizimin e veprimtarive në komunitet. Duke punuar së bashku, ata informuan burrat e Kuçovës për Ditën Ndërkombëtare dhe qëllimin e saj. Burrave iu kërkua që të vizatonin një skicë të dorës së tyre në një letër, duke shkruar "Kjo dorë nuk do të të lëndojë asnjëherë."

Ndikimi - Morën pjesë një numër i konsiderueshëm burrash në Kuçovë. Ata nënshkruan letrën, shkruan disa fjalë të ngrohta dhe ia dorëzuan atë një njeriu të dashur.

Burrat në Kuçovë vizatuan një skicë të dorës së tyre në fushatën e VKP-së Juliet Kosarzycki për të ndaluar dhunën në familje.

2002 — Qeveria Shqiptare ftoi Korpusin e Paqes për të rihapur një program në vend

SHTATOR 2003 — Në Shqipëri mbërriti një grup i ri me VKP për Zhvillimin e Komunitetit

2004 — Programi u zgjerua për të përfshirë mësimdhënien e gjuhës angleze dhe edukimin shëndetësor

2007

Festojmë 20 vjet në Shqipëri 2010-2017

Gratë shtatzëna në Shkodër ndjekin orën e edukimit të lindjes së fëmijës, e drejtuar nga vullnetarët e Korpusit të Paqes Shqipëri.

Informimi për procesin e lindjes së fëmijës - Në Shkodër, nënat që presin të lindin u informuan rreth procesit të lindjes së fëmijëve nga profesionistë. Të gjitha nënat e ardhshme ishin të keqinformuara, gjë që shtoi frikën dhe ankthin.

Veprimtaritë - VKP Barbara Stallings nga Nju Meksiko, që kishte shërbyer si vullnetare nga viti 2009 deri në vitin 2011, e informoi komunitetin për procesin e lindjes së fëmijës. Klasat u trajnuan nga një "Edukator për Procesin e Lindjes së Fëmijës" nga Shqipëria, me njohuri në infermieri dhe terapi fizike. Vitin e ardhshëm, VKP Jessica Goodell (2010–2012, nga Florida) e zgjeroi qëllimin e projektit me anë të zhvillimit të një programi trajnimi për rritjen e numrit të edukatorëve të kualifikuar.

Ndikimi – Në seancat e para morën pjesë 11 nëna të ardhshme dhe 1 baba i ardhshëm. Në fazën e 2-të, u trajnuan 20 edukatorë për kurset e edukimit të lindjes së fëmijës.

2011

2012

Korpusi i Paqes Shqipëri mori "Urdhrin Nënë Tereza" nga Presidenti i Shqipërisë, për ndihmën e paçmueshme dhe kontributet e vullnetarëve për Shqipërinë

2017

Korpusi i Paqes feston 20 vjet shërbimi në Shqipëri

Ngjarjet kryesore nga festimi i 20-vjetorit

KONFERENCA ME TË GJITHË VULLNETARËT

Në Konferencën vjetore me të gjithë vullnetarët, u zhvillua një bisedë në Skype me ish-senatorin amerikan, Harris Wofford. Ai shërbeu si Ndihmësi Special i Presidentit Kenedi për të Drejtat Civile dhe ndihmoi në themelimin e Korpusit të Paqes. Më vonë, ai ndihmoi në krijimin e AmeriCorps, nën udhëheqjen e presidentit Klinton. Senatori Wofford përfaqëson idealet e shërbimit dhe të përfshirjes civile.



PROJEKTI I SHËRBIMIT

Korpusi i Paqes Shqipëri, në bashkëpunim me Departamentin e Parqeve të Tiranës dhe rreth 70 të rinj, punuan në një projekt shërbimi në Parkun e Liqenit të Tiranës. Korpusi i Paqes Shqipëri rekrutoi të rinjtë për mbështetjen e projektit, si pjesë e nismës për të frymëzuar vullnetarizmin dhe përfshirjen civile.

PANELI I VULLNETARIZMIT

Për temën e vullnetarizmit u organizua një panel diskutimi i bashkisë së qytetit. Folësit e panelit ishin Blendi Gonxhe, drejtor i parqeve në Tiranë dhe një nga studentët e kryengritjeve të vitit 1990, që kontribuuan në rënien e komunizmit në Shqipëri; Arbër Hajdari, themelues i OJF-së vullnetare "Fundjavë Ndryshe"; Manjola Gega, mësuese nga Rrësheni dhe anëtare e bordit të Vajzave Udhëheqëse të Shqipërisë; Ola Keci, studente e Universitetit të Tiranës dhe banore e Shijakut, e frymëzuar nga një ish-VKP në vitin 2010; dhe ambasadori amerikan në Shqipëri, Donald Lu.



Korpusi i Paqes Shqipëri në vitin 2017

- 148 Vullnetarë;
- 3 sektorë:
  - Mësimdhënie e gjuhës angleze;
  - Edukim shëndetësor;
  - Zhvillimi i komunitetit dhe organizimit;
- Të vazhdohet partneriteti me bashkitë, ministritë dhe OJF-të, dhe kalimi i emërimeve në komunitete më të vogla, që kanë më pak burime;
- Theksim i shtuar i çështjeve mjedisore, zhvillimit të turizmit dhe qëndrueshmërisë së projekteve përmes mbështetjes dhe pronësisë vendore.

Kush janë vullnetarët e Korpusit të Paqes Shqipëri?

Vullnetarët e Korpusit të Paqes vijnë nga të gjithë cepat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të sjellë një ndryshim rrënjësor në Shqipëri. Vullnetarët shkëmbejnë vlerat dhe perspektivat e tyre të origjinës me komunitetin pritës në të cilin shërbejnë, një shkëmbim ndërkulturor që sjell paqe dhe miqësi.

Kush janë vullnetarët e Korpusit të Paqes Shqipëri?

3

Vullnetarë kanë shërbyer si të tillë edhe më parë!

Mary Lou Surgi, Malajzi, 1978-1980
Marilyn Matt, Armeni, 2008-2010
Mike Bailey, Kinë, 2013-2015



1

Vullnetar u bë qytetar amerikan për t'iu bashkuar Korpusit të Paqes

Arsimimi

(2%)
(0,5%)
(16%)
(100%)

Kush janë vullnetarët e Korpusit të Paqes Shqipëri?



Gjuhët

Gjuha angleze nuk ishte gjuha amtare e **8%** të të anketuarëve*

48% e të anketuarëve flasin 1 gjuhë tjetër, përveç gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe

3 të anketuar* flasin 2 gjuhë të tjera shtesë

2 të anketuar* flasin 3 gjuhë të tjera shtesë

1 i anketuar* flet 4 gjuhë të tjera shtesë



i të anketuarëve* me

1 fëmijë	2 fëmijë	3 fëmijë	4 fëmijë

i të anketuarëve* me

- Prind 1
- Fëmijë 2
- Hallë ose teze/xhaxha ose dajë 4
- Kushuri 1
- Mik ose koleg i afërt 33

që ka qenë ose është Vullnetar

** I referohet një anketimi të Vullnetareve, qe punuan ne Shqiperi në 2017, në të cilin vetëm 58% e plotësuan anketimin.*

Synimet e vitit 2017 sipas sektorëve

Edukimi shëndetësor

1: Shëndeti seksual dhe riprodhues
Të rinjtë do të përvetësojnë sjellje dhe praktika që kontribuojnë në shëndetin e përmirësuar seksual dhe riprodhues.

2: Mënyrat e shëndetshme të jetesës dhe aftësitë për jetën
Të rinjtë do të përvetësojnë aftësi për jetën, që janë të nevojshme për të marrë vendime të përgjegjshme dhe të shëndetshme, dhe të bëjnë veprime, që ndikojnë pozitivisht në jetën e tyre dhe në jetët e njerëzve përreth tyre.

Peace Corps
ALBANIA

Mësimdhënie e gjuhës angleze

1: Përmirësimi i mësimdhënies
Mësuesit dhe udhëzuesit e gjuhës angleze do të përmirësojnë zotërimin e gjuhës angleze, metodat e mësimdhënies dhe aftësitë për zhvillimin e burimeve.

2: Rritja e suksesit të studentëve
Studentët do të mund të përmirësojnë zotërimin e gjuhës angleze, komunikimin, dhe aftësitë për jetën përmes udhëzimit për gjuhën angleze në klasa ose përmes veprimtarive jashtëkurrikulare.

3: Fuqizimi i shkollës dhe i komunitetit
Mësuesit, stafi i shkollës dhe administratorët, dhe anëtarët e komunitetit të gjerë do të forcojnë bashkëpunimin dhe do të jenë pjesëmarrës më aktivë dhe lidera të shkollës së komunitetit të tyre.

Zhvillimi komunitar dhe organizativ

1: Zhvillimi organizativ
Organizatat vendase dhe grupet komunitare do të fuqizojnë aftësitë dhe proceset menaxheriale/operacionale dhe organizative.

2: Ndërtimi i Shoqërisë Civile
Individët do të rrisin kapacitetin e tyre për të marrë pjesë në shoqërinë civile vendore dhe në zhvillimin e komunitetit.

Të rinjtë e Pukës të trajnuar në bletari

Zhvillimi komunitar dhe organizativ—Në vitin 2016, të rinjtë në Pukë vëzhguan se sa i pëlqyer ishte mjalti i famshëm i rajonit dhe kuptuan se ishte një mënyrë për të gjeneruar të ardhurat familjare. Ata kërkuan ndihmën e biznesit Agro-Puka, një OJF fermë bujqësore vendore, për t'i ndihmuar që të mësonin artin e bletarisë. Të rinjtë formuan një rreth studimi për të shkëmbyer njohuri, për të pasur akses në informacione, dhe për të mësuar së bashku. Ata e quajtën e grupin e tyre "I ëmbël si mjalti". Vullnetarja e Korpusit të Paqes Mary Lou Surgi është vullnetare në fermën Agro-Puka.

Veprimtari - Të rinjtë studiuan bletarinë, me ndihmën e një eksperti bletësh të zonës. Mary Lou ofroi mbështetje teknike dhe aplikoi për një grant të Asistencës së Projekteve të Vogla të Korpusit të Paqes, i financuar nga USAID/Shqipëri. Në vitin 2017, ky grant i mundësoi grupit pajisjet bazë për bletët, kosheret e bletëve, pajisjet për rritjen e tyre, po ashtu mbështetje shtesë gjatë gjithë vitit.

Ndikimi - Në muajin shtator, grupi "I ëmbël si mjalti" prodhoi kavanozat e parë me mjaltë dhe u paraqit në Panairin e Vjeshtës të vitit 2017, i organizuar nga ferma Agro-Puka.

Vullnetarja Mary Lou Surgi (djathtas) sheh se si një lider rinor i fermës Agro-Puka inspekton disa nga bletët e grupit.

8,240 **Individë në Shqipëri rritën kapacitetin e pjesëmarrjes në shoqërinë civile vendore dhe në zhvillimin komunitar në vitin 2017, për shkak të programit të Zhvillimit Komunitar dhe Organizativ nga Korpusi i Paqes Shqipëri.**

Fëmijët e nënshërbyer në Kamëz kalojnë kohë në Kampin Veror të Lidershipit

Mësimdhënia e gjuhës angleze - Lagjja Bathore-Kamëz është një lagje e nënshërbyer, e përbërë kryesisht nga migrantë nga Veriu i Shqipërisë, që erdhën në këtë zonë për të gjetur punë në vitet '90. Prindërit e kësaj zone të varfër periferie shpesh nuk kanë akses në fondet, që t'iu ofronin fëmijëve të tyre aktivitete argëtuese dhe të organizuara gjatë verës.

Veprimtaria - Eriku, një mësues vullnetar i Korpusit të Paqes për gjuhën angleze në shkollën e Kamzës, ndihmoi në organizimin e "Kampit Veror për Qytetari Aktive", për të mësuar aftësi lidershipi dhe për të ofruar veprimtari të organizuara. Partneri i Korpusit të Paqes Shqipëri, World Vision, e mbështeti kampin me materiale, drekë, dhe programe mësimore. Eriku ndihmoi në koordinimin e aktiviteteve, si promovimi i kampit, dhe duke qenë ndërmjetës me World Vision, duke i trajnuar studentët lidera për të përgatitur aktivitetet ditore, dhe për të lehtësuar veprimtaritë në terren.

Ndikimi - Pjesëmarrja ditore në kamp ishte 40 deri në 80 fëmijë. Ata mësuan rreth gjithëpërfshirjes, zgjidhjes së problemeve, bashkëpunimit, strategjitë planifikuese, dhe përgjegjësitë qytetare gjatë argëtimit.

Katër djem nga "Kampi Veror për Qytetari Aktive" i Erikut, vullnetarit të Korpusit të Paqes, dalin nga ambientet e shkollës në lagjen Bathore-Kamëz.

360 Mësues punuan me VKP-të për të përmirësuar mësimdhënien dhe për të zhvilluar burime.
6,600 Studentë morën mësime për gjuhën angleze dhe lidershipin nga VKP-të dhe nga mësuesit e tyre kolegë.
400 Anëtarët e shkollës dhe komunitetit u angazhuan në veprimtaritë për fuqizimin e shkollave dhe komuniteteve.

Studentët e qytetit të Përmetit gëzojnë një mjedis natyror të shëndetshëm dhe të sigurt

Edukimi Shëndetësor - Barbara Grant, një mësuese vullnetare për shëndetin, në qytetin e Përmetit, vuri re se fëmijët në shkollën e saj 9-vjeçare, "Meleq Gosnishti", nuk kishin ambiente të pastra dhe të sigurta për të ngrënë gjatë pushimit të gjatë ose për veprimtaritë jashtëshkollore.

Veprimtari - Barbara siguroi vendosjen e disa tavolinave dhe stolave me ndihmën e një granti të Asistencës së Projekteve të Vogla të Korpusit të Paqes, i financuar nga USAID/Shqipëri. Secili prej stolave dhe tavolinave ishte prodhuar për të qenë rezistent ndaj motit dhe të përshtatej me natyrën. Tavolinat ishin prej betoni dhe hekuri; stolat ishin prej druri. Në pjesën e sipërme të tavolinave gjendeshin mozaikë të ndryshëm, të krijuar nga vajzat që kanë ndjekur klubet "Girls Lead Our World" (GLOW), të drejtuara nga Barbara. Në të gjithë zonën u vendosen edhe kosha për mbeturinat.

Ndikimi - Tanimë 400 nxënës të shkollës kanë mundësinë të hanë, të ulen ose të bëjnë veprimtari në natyrë, duke përdorur 6 tavolina dhe 30 stola, të vendosur si rezultat i përpjekjeve të Barbarës.

Vajzat nga Përmeti, të klubit GLOW të VKP-së Barbara, i japin dorën e fundit vendosjes së mozaikëve mbi pjesën e sipërme të një tavoline në shkollën 9-vjeçare Meleq Gosnishti.

12,187 — **Individë në Shqipëri morën pjesë, në vitin 2017, në kampe verore, klube, veprimtari sportive, dhe trajnime formale, për të mësuar rreth abuzimit me substancat, aftësitë për jetën, dhe shëndetin riprodhues, nga programi i Edukimit Shëndetësor të Korpusit të Paqes Shqipëri.**

Programet me grante të vogla për vitin 2017

Programi i Partneritetit i Korpusit të Paqes

Programi i Partneritetit i Korpusit të Paqes bashkon vullnetarët dhe komunitetet e tyre me sektorin privat në SHBA dhe në botës, për të financuar projekte me nismën e komunitetit.

$5,629
I jepen Korpusit të Paqes Shqipëri për vitin 2017

2 Projekte	**2** Komunitete

Peace Corps

Asistenca e Projekteve të Vogla

Vështrim i përgjithshëm

180
Projekte janë financuar dhe zbatuar në Shqipëri që nga krijimi i programit në vitin 2004

$2,000 – $4,000
Financimi për çdo projekt përmes granteve të APV-së

25%
Sasia e fondeve për kontributin në komunitet

Në vitin 2017

$60,000
Sasia e ofruar nga USAID/Shqipëri për grantet e Asistences se Projekteve te Vogla

9
Projekte të vogla komunitare të financuara

4
Workshop-e për Hartimin dhe Menaxhimin e Projektit, të financuara për dhe kolegët e tyre

LET GIRLS LEARN

$13,070 Sasia e ofruar nga LGL për Korpusin e Paqes Shqipëri për vitin 2017	**8** Projekte	**7** Komunitete

Organizatat tona Partnere në vitin 2017

Organizatat jofitimprurëse (OJF-të)

- Agro-Puka;
- Këshillat amerikanë;
- Qendra ARKA—Shkodër;
- CSDC Durrës;
- Darien Book Aid;
- Shoqata e mësuesve të gjuhës angleze;
- Epoka e Re;
- Banka e ushqimit;
- Friends of Albania;
- Lerda;
- Mary Ward Loreto;
- Agjencia e Zhvillimit Rajonal – Korçë;
- Sidi Education;
- Terre des Hommes;
- Water Charity;
- World Association of Girl Guides and Girl Scouts;
- World Connect;
- World Vision;
- Qendra Rinore – Vlorë;
- Youth in Free Enterprise.

Organizatat qeveritare dhe të pavarura

- Kryqi i Kuq Shqiptar;
- Dhoma e Tregtise – Vlorë;
- Drejtoritë e Shëndetit Publik;
- Instituti i Zhvillimit Arsimor;
- Instituti i Shëndetit Publik;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore;
- Agjencitë e Zhvillimit Rajonal në Vlorë, Korçë dhe Tiranë;
- Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare – Gjirokastër;
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror – Berat;
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror – Durrës;
- Kombet e Bashkuara në Shqipëri;
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë;
- Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID);
- Ambasada e Shteteve të Bashkuara dhe Këndet Amerikane;
- Universiteti i Tiranës, Departamenti i gjuhës angleze.

Bashkitë

- Berat;
- Elbasan;
- Ersekë;
- Fier;
- Kavajë;
- Korçë;
- Krujë;
- Kuçovë;
- Lushnjë;
- Malësi e Madhe;
- Mirditë;
- Roskovec;
- Shijak;
- Vau i Dejës.

Zyrat Arsimore në qarqe dhe rrethe

- Berat;
- Dibër;
- Durrës;
- Elbasan;
- Fier;
- Gjirokastër;
- Korçë;
- Kukës;
- Lezhë;
- Shkodër;
- Qyteti i Tiranës;
- Rrethi i Tiranës;
- Vlorë.

Stafi ynë i rregullt me kohë të plotë në vitin 2017

Korpusi i Paqes Shqipëri është krenar që ka një staf të përkushtuar, i përbërë nga amerikanë dhe shqiptarë. Së bashku, ata mbështesin vullnetarët tanë çdo ditë të vitit, për t'i ndihmuar në realizimin e qëllimeve të tyre ndaj shërbimit. Në vitin 2017, stafi ynë vijoi të ishte profesionist dhe pozitiv gjatë rinovimit të të gjithë ndërtesës, dy trajnimeve para marrjes së detyrës për vullnetarët e rinj, brenda një periudhe 12-mujore, dhe zbatimit të politikave të reja, që kërkonin punë shtesë, të gjitha këto krahas përgjegjësive të zakonshme që kishin. Përpjekjet e tyre e bëjnë Korpusin e Paqes Shqipëri kaq të suksesshëm.

Agim Dyrmishi
Alsida Myrtaj
Anida Tulo
Arben Cako
Arben Loci
Ardiana Brahja
Besa Arapi
Cale Wagner
Darina Kaltani
Diana Djaloshi
Dritan Gjoshi
Dritan Kamberi
Elsona Cupi
Gentian Leka
Gentian Mano
Ilir Memlikaj
Ilir Ziu
Iris Dollia
Iva Sinani
Jason Kane
Kate Becker*
Kyle Olsen*
Kenneth Johnson
Marie Aughenbaugh*
Marjeta Zavalani
Marsela Loci
Mira Luca
Mirela Tahiraj
Monika Mukja
Poleta Luka
Rudina Lubonja
Ylli Cupi

*Ekipi ekzekutiv

Stafi ynë i përkohshëm me kohë të plotë në vitin 2017

Korpusi i Paqes Shqipëri punëson çdo vit rreth 20 persona të përkohshëm, që luajnë një rol të rëndësishëm në trajnimin para marrjes së detyrës për vullnetarët tanë të rinj. Këta individë janë po aq të përkushtuar ndaj idealeve dhe misionit të Korpusit të Paqes sa edhe stafi ynë i rregullt. Ata janë pjesë e familjes sonë çdo vit dhe kur trajnimi para marrjes së detyrës përfundon, është shumë e vështirë që t'iu themi mirupafshim. Ata iu mësojnë vullnetarëve tanë një gjuhë të re, i mbajnë të sigurtë, të shëndetshëm dhe të organizuar. Korpusi i Paqes Shqipëri është këtu ku është vetëm falë përpjekjeve të tyre.

Ali Gjiriti
Altina Peshkatari
Ana Harja
Besmira Rrumbullaku
Brunilda Peqini
Diamanta Vito
Elona Kafexhiu (Pajova)
Elvana Stambolli
Erion Kumuria
Ervin Bebeti
Esmeralda Dogani
Imelda Celibashi
Ina Tollumi
Ledion Veshi
Marsida Rrupulli
Vjollca Merdani
Ymer Leksi
Zamir Mero
Zerina Zeneli

Na kontaktoni

Korpusi i Paqes Shqipëri
Rr. Besnik Sykja, Godina 2
Hyrja 1, Kutia Postare 8180,
Tiranë, Shqipëri

Numri i telefonit:
+355 42 365 5033

Adresa e email-it:
info@al.peacecorps.gov

Faqja e internetit:
peacecorps.gov/albania/

Adresa në rrjetin social Facebook:
facebook.com/albania.peacecorps